

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
ADRESA	https://lapsi.al/andi-bushati-haga-si-perfundim-i-nje-epoke-te-gjate-yes-man-izmi-i1093947
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 14:28:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 14:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c9303fc14b3375fc973ed4a37ebca8f91a219284ad40cf6828e30b89764437e7
TEKSTI	bc8745200856af22b08cb0376d786ca1cb3ea87faeacc9cce8fbb664b5a83d97
PAMJA	99465274d36abe739f7113959b7a6bbf9d22255a484013b03cbe8f69ae6a1611

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a85acec4ac3925ef33cec273cd4fb3b710ff5f52343960689bf4fb821f753939
E MËPARSHMJA	469dce5d2bbd7a4eb2fda0e14f25a597fdc7f22e16d99331cab9b0bb7158c2f5
RRËNJA MERKLE	dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a85acec4ac3925ef33cec273cd4fb3b710ff5f52343960689bf4fb821f753939

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi

Nga drama e 16 shtatorit, që po rekemi ta konsumojmë si popujt primitivë me lotë, mallkime, ofshama dhe qurravitje duhet të dimë të nxjerrim një mësim: Këtëj e tutje askush nuk do të na rrespektojë, po nuk ditëm të respektojmë vetveten. Sepse verdikti i asaj gjykate të instrumentalizuar erdhi si pasojë e servilizmit tonë të verbër ndaj perëndimit



ANDI BUSHATI • 17 SEPTEMBER 2026

Përtej lotëve, ofshamave qurravitjeve, mallkimeve që shpërthyen gati-gati me intensitetin e neveritshëm të një protagonizmi të pavend, porsa në Hagë u shpall një dënim sa i padrejtë po aq dhe i ekzagjeruar ndaj ish drejtuesve të UÇK-së, kjo dramë që përgatitet prej më shumë se një dekadë mund të na shërbejë edhe për një mësim. Gjeneza e saj më shumë sesa tek Serbia apo Rusia, që i mallkojmë kollaj; më shumë sesa tek viktimat e rugoviste apo ata afro 200 shqiptarë 'bukëshkalë', që pranuan të dëshmojnë në proces; më shumë sesa tek instrumentalizimi i prokurorëve apo gjykatësve specialë, që u treguan edhe më të rreptë se paraardhësit e tyre në Nuremberg; pra më shumë se tek faktorë periferikë të këtij procesi duhet kërkuar brenda një mentaliteti mbizotërues në shoqërinë tonë.

Ajo është pasojë e servilizmit ekstrem që ne kemi kultivuar ndaj asaj që na diktohet prej SHBA-ve dhe aleatëve të tjerë perendimorë.

Për të kuptuar këtë duhet ta kthejmë filmin në vitet 2011-2015, pra në atë kohë kur nuk qemë në gjendeje të ndërmerrim hapat e duhur kundër raportit të Dik Martit në Këshillin e Evropës e deri në ditën kur parlamenti i Kosovës votoi për ngritjen e dhomave të specializuara. Të gjithë, pa përjashtim, e dinin se ngritja e këtij organi "sui generis", që do të jepte vendime në emër të popullit të Kosovës me dosje të servitura nga Serbia, do të përfundonte me vendosjen e një njolle turpi. Mjafton të shikosh sot fjalimet e mbajtura në kuvend, në vitin 2015, qoftë ato të Hashim Thaçit, që bënte thirrje për ngritjen e kësaj gjykate, qoftë ato të Albin Kurtit që shpallte argumentat se përse duhej votuar kundër, për të konkluduar se këta dy liderë ekstremisht të ndryshëm bashkoheshin në një pikë: se kjo ishte një sakrificë me pasoja për të ardhmen e Kosovës dhe për imazhin që do të linte në histori lufta e saj çlirimtare.

Lexo më tej



16 SHTATOR, 17:57

Revolta në Prishtinë, kënaqësi në Beograd/ Si u prit dënimi me burg për ish-krerët e UÇK-së

Por, këto dy lexime përafërsisht të njëjta të situatës divergonin në dy rrugëzgjdhje krejtësisht të ndryshme. Hashimi përfaqësonte një shumicë dërrmuese në shoqëri, në Prishtinë dhe Tiranë, e cila besonte se ne duhet ti bindemi symbyllur Uashingtonit dhe Brukselit, sepse e vetmja forcë që kemi është aleanca, qoftë edhe në gabim, me ta. Albini, i pritnte një grupi ku e ku më të vogël në numur, ndonëse më parimor e me të gatshëm për të vënë trurin në punë, që predikonte se nëse i bindemi me çdo çmim partnerëve tanë, nuk mund të pretendojmë më që ata të na duan më shumë sesa veten.

Sot ne po e shohim para syve produktin e zgjidhjes që i dhamë kësaj dileme. Po, është e vërtetë që UÇK-ja ka njollat e saj kriminale. Po është e vërtetë që shumë komandantë e përdorën luftën çlirimtare për tu pasuruar personalisht dhe për ta shfrytëzuar si

ide

**Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi**

Andi Bushati

**Gënjeshtër e rezortëve elitare**

Blendi Kajsia

MOTITIRANA

27°C

KËMBIMIEURO

91.65

aktuale

08:06

Seancë brenda, protestë jashtë/ Qytetarët zhvendosen para Kuvendit

08:02

**Seancë maratonë në Kuvend/ Pesë interpelanca në rend dite, sot vendoset edhe për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve****TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë**

Ndiqe Lapsin edhe në

**Me interes nga publiku**

trampolinë për pushtetin në shtet, duke eliminuar kundërshtarët.

Por, sado të vërteta të jenë këto mëkate deri më dje të pandëshkuara, pyetja është nëse insistimi i aleatëve tanë perëndimorë për ngritjen e një Gjykatë Speciale u motivua nga merakut idealist për të zbardhur këtë pjesë të errët?


Dyshoj se jo! Me shumë gjasë ajo që një karrem për të afruar Beogradin dhe një pjesë këmbimi në negociatat me Moskën. Këtë pandehmë e përforcojnë më shumë edhe qëndrime si ato të ndonjë ish zyrtari amerikan që ka treguar për dhuratën që iu bë Rusisë për të pranuar marveshjen e kontrollit bërthamor të Iranit. Gjithçka e bën edhe më evidente mënyra se si u arrestua Hashim Thaçi dhe forcat që vendosën në kulisa ta bëjnë këtë, ndërkohë që ai pati marrë avionin për të nënshkruar një marrëveshje në Shtëpinë e Bardhë.

Pra, gati një shekull burg për ish kretër e UÇK që morrëm në këmbim, mund të mos kenë qenë asgjë më shumë sesa keqpërdorja e besimit qorr që ne i dhamë Brukselit dhe Uashingtonit. Deputetët e Kosovës në vend që të shkonin me bisht në shalë për të votuar ndryshimet kushtetuese, të imponuara nga jashtë, minimumi duhet të kishin bërë përpjekje për të kërkuar rrugë alternative, qoftë me ngritjen e një institucioni vendas me gjyqtarë të huaj, qoftë me ndonjë zgjidhje nën mbikqyrjen e Eulex. Qeveritarët e asaj kohe duhet të kishin eksploruar rrugë të reja pa u bindur si yes man-ë ndaj propozimit unik të aleatëve. Tirana zyrtare duhej të ushtronte presion për mos realizimin e kësaj zgjidhjeje ekstreme, në vend që të niste kryeministrin me helikopter si emisar të amerikanëve.

Të gjithë ata që morën vendimin u bënë bashkë me një slogan: ``Do ti'u bindemi partenrëve strategjikë``.

Tani, me vonesë, shumë vite më pas, kur ishte bindur se gjërat po shkonin keq e më keq, ish presidenti Thaçi u justifikua se e pati hedhur këtë hap, pasi e kishin kërcënuar se Gjykata do të ngrihej gjithësesi, qoftë edhe nëse Kosova nuk pranonte ta donte, porse në këtë rast do të qe më keq, pasi vendimi për të do të merrej në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ku gjendeshin edhe vende jo aleate si Kina e Rusia.

Lexo më tej



16 SHTATOR, 12:52

Nga torturat te vrasja e 96 personave/ Pse i dënoi Haga katër ish-krerët e UÇK-së

Duke mos e ditur se sa i panegociueshëm ishte ky version dhe mbi të gjitha, se si do të përfundonte kjo rrugë e panjohur, një gjë është e sigurtë, duke rrefuzuar të pranonin diçka që i dukej e padrejtë, në dëm të imazhit të vendit të tyre dhe me pasojë për të ardhmen, liderët e Kosovës mund të mos shmangnin dot pasojat e rënda por së paku do të ruanin dinjitetin.

Duke u sjellë si servilë ata i sakrifikuan të dyja edhe bindjen e tyre edhe llogaritë e viteve të burgut.

Pasi sot pyetja shtrohet: A mund të ndodhte më keq sesa kaq: A mund të kishte një përfundim më të errët sesa një gjykatë, që e dënoi Hashimin e Kadriun me dyfishin e viteve burg që u kishte dhënë Serbia dhe që i njohu atyre përgjegjësi kolektive që Tribunali Kundër Krimeve në ish Jugosllavi, nuk kishte pranuar ta bënte për Ramush Haredinajn?

Disfata si numerike dhe morale është më e madhja e mundshme. Ajo është mbi të gjitha pasojë e një verbërie të padurueshme kundrejt perëndimit. Pasojë e një "PO"-je të dhënë vetëm në emër të parteritetit. Pasojë e një përkuljeje që s'mund të ketë lidhje me mirënjohjen për atë që aleatët na "dhuruan" në 1999. Prandaj nga drama e 16 shtatorit, që po rekemi ta konsumojmë si popujt primitivë me lotë, mallkime, ofshama dhe qurravitje duhet të dimë të nxjerrim një mësim: Këtej e tutje askush nuk do të na rrespektojë, po nuk ditëm të respektojmë vetveten. Pas episodeve më minore si ato me



Nga torturat te vrasja e 96 personave/ Pse i dënoi Haga katër ish-krerët e UÇK-së



"Marre", Ramën e bëjnë copë në rrjetet sociale pas dënimit të Hashim Thaçit



VIDEO/ Del nga SPAK arkitekti që projektoi vilën e Belinda Ballukut



Departamenti amerikan i Shtetit i vë kapakun, përshëndet dënimin e ish-krerëve të UÇK

“non grata”-n në Shqipëri, apo me asociacionin në Kosovë, vendimi i fundit i Hagës duhet të konsiderohet si mbyllja e epokës së servilizmit pa kushte ndaj perëndimit.

LAPSI.AL

Të këshilluara



Gënjeshtra e rezortëve elitare

Në Sazan edhe në Zvërnec qeveria po financojnë komplekse luksoze banimi që do pasurojnë ndërtues lokal dhe ndërkombëtarë, herë duke i hequr taksat, herë duke i çuar infrastrukturë dhe herë duke privatizuar tokën dhe plazhet publike



Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

Deri më tani për ta nxjerrë Lalin nga burgu u përdor alibia e mos dëmtimit të interesit të qytetarëve dhe punëve të Tiranës. Këtë e tutje, pasi mirë apo keq, Gjykata e Lartë vendosi të lërë edhe për një kohë relativisht të gjatë të izoluar, duhet të jesh i pafytyrë që të mbrosh idenë se ai mund të mbetet kryebashkiak edhe në dëm të këtij interesi



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit



Insistimi tek krimi, arsyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet

Insistimi i Ramës se projekti në Zvërnec do zhvillohet edhe pse ai është tashmë simbol i një krimi të trefishtë (ambiental, ekonomik dhe politik) të qeverisjes aktuale tregon se ai ose nuk mundet ose nuk do të degjoje thirrjen e protestes



Fabula e re e Edi Ramës: Shqiptarëve pasqyrën, për vete milionat

Në sallat mortore të rilindjes, të gjithë e dinë se pallavrat e kryeministrit nuk mund ta ndryshojnë realitetin ku ata e kanë sjellë vendin. Asnjë pasqyrë nuk reflekton dot një Shqipëri tjetër nga ajo që ekziston në të vertetë.



Blendi Kajsiu: Skandali i vërtetë në rastin Veliaj

Që në momentin e marrjes si i pandehur një standarti politik minimal diktonte dorëheqjen e tij nga detyra në funksion të interesit të Tiranës dhe qytetarëve të saj



Po sikur Lali të dalë nga burgu?



Një moment vendimtar për Shqipërinë

Është hera e parë që shqiptarët ndihen se mund ta formësojnë debatin kombëtar pa pritur që partitë politike të marrin drejtimin. Përvoja na mëson se demokracia varet jo vetëm nga zgjedhjet, por edhe nga qytetaria aktive mes tyre.



Ngatërresa e madhe me Ergys Agasin

Ato që tregojnë më pak për historinë e "Gysit" janë pamjet dhe deklaratat e nxjerra nga arkivat për lidhjen e tij me Ramën. Pasi nuk është i pari që njollos të dytën



Pogradeci, si inerci e Shqipërisë së djeshme

Edi Rama po sillet sikur paqja sociale mund të rivendoset duke armuar modelin e vjetër të qeverisjes, ndërkohë që ata që kërkojnë dorëheqjen e tij e bëjnë këtë në emër të përmbyesjes së një sistemi

Me sytë katër



22:48


PAMJET/ 12 vite më parë Thaçi qeshte kur Albin Kurti i kërkoi të mos e votonte Specialen

Në prill të vitit 2014, kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, asokohe deputet i Parlamentit, paralajmëroi Hashim Thaçin për...



PAMJET/ Shqiptarët "pushtojnë" gjykatën e Hagës para vendimit për krerët e UÇK-së

21:25



"O hajdut, o hajdut...", shihni si iu ikën protestuesve Taulant Balla (VIDEO)

20:44



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit.



Pamie të rënda/ Avokati amerikan i

Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

20:36

drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43

SPORT

→ Të tjerë artikuj



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.